

KËRKESË
Nr. 2730, datë 7.5.2015

PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Maminas-Gjiri i Lalzit”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit “objekte”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 7 384 399 (shtatë milionë e treqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONESIMEVE

LISTA E PRONARËVE TË OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR "MAMINAS-GJIRI I LALËZIT"

Nr.	Emri - Atësia - Mbiemri	Nr. Z. Kad.	Nr.Pasurisë	Sipërfaqe ndërtimi	Lloji i objektit	Vlera (Lekë)	Sbënime
1	Sefer Luku	2590	443/10	56m2	Ndërtesë	2,007,970	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Hasan Zenel Sallaku	3137	62/11	72m2	Objekt banimi	2,515,344	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Kalem Sallaku	3137	63/21		Mur rrethues	347,971	Leje ndërtimi
4	Naim Zyber Gjergji	2065	38/33	30m2	Ndërtesë	1,391,972	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Fadil Hoxha	3137	76/5	66m2	Objekt shërbimi	629,094	Leje ndërtimi
6	Rustem Hoxha	3137	62/9		Mur rrethues	492,048	Leje ndërtimi
	SHUMA TOTALE					7,384,399	